

Të nderuar,

Në fillim të çdo viti, që kur jam emëruar kryetar i Trupit koordinues të Qeverisë së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, me anë të një letre ju kam dërguar raport për atë se çka është punuar në vitin e kaluar. Kam kënaqësinë që edhe me anë të kësaj letre t'ju njoftoj për rezultatet e rëndësishme të punës së Trupit koordinues.

Suksesi jonë më i rëndësishëm është formimi i pushtetit multietnik në Bujanoc. Pas më shumë se dy viteve pas zgjedhjeve lokale, në zgjidhjen e problemeve janë inkuadruar edhe përfaqësuesit e bashkësisë serbe. Kjo është një hap i madh përpara në jetën e përbashkët dhe parakusht për përparim të bashkësisë lokale. Jemi krenar edhe për përkrahjen tonë formimit të Këshillit Nacional të Shqiptarëve që merret me çështjet e gjuhës, informimit, arsimit dhe kulturës së kësaj bashkësie nacionale. Është vendosur bashkëpunim në mes të Këshillit nacional të Shqiptarëve dhe Trupit koordinues para së gjithash në zgjidhjen e çështjes së arsimit.

Lidhur me këtë është formuar Grup i posaçëm për sigurimin e kushteve për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë në Preshevë dhe në Bujanoc, që ka për detyrë të përcaktojë mundësitë për hapjen e njësive të arsimit të lartë në jug të Serbisë. Grup të posaçëm punues përbëjnë përfaqësuesit e Ministrisë së arsimit, Trupit koordinues, Këshillit nacional të Shqiptarëve, eksperti vendor për çështje të arsimit të lartë dhe këshilltari i Komesariatit të lartë për pakica nacionale para OSBE-së. Trupi koordinues për përfaqësuesit e grupit të posaçëm punues, të Këshillit nacional të shqiptarëve dhe bashkësisë serbe, në kuadër të Programit të Kombeve të bashkuara, ka organizuar vizitën studimore në Vojvodinë për të pasur qasje në modele të ndryshme të organizimit të arsimit të lartë në mjediset multietnike. Gjatë vizitës anëtarët e Grupit të posaçëm punues janë takuar me përfaqësuesit e Universitetit të Novi Sadit dhe Këshilleve nacionale të Hungarezëve, Rumunëve dhe Sllovakëve. Këtë vit është planifikuar që për 80 deri 100 studentë në Bujanoc të hapet dega e Fakultetit ekonomik të Universitetit në Nish.

Është formuar edhe grupi punues për zgjidhjen e problemit të teksteve mësimore për mësim në gjuhën shqipe të cilin e udhëheq ndihmës ministri i arsimit.

Për studentët e bashkësisë nacionale shqiptare të cilët kanë regjistruar vitin e dytë të fakultetit Ekonomik dhe Juridik të Universitetit të Nishit, degës në Medvegjë, Trupi koordinues ka siguruar tekste mësimore në gjuhën e tyre amtare, kurse të gjithë studentët të cilët kanë regjistruar vitin e dytë nga Trupi koordinues kanë marrë nga shtatë mijë dinar.

Me qëllim të forcimit të ekonomisë në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, Trupi koordinues në vitin 2010, në projekte infrastrukurore ka investuar 229.278.000,00 dinar.

Në komunën e Preshevës janë investuar 91.948.590,00 dinar për rekonstruimin e qendrës së qytetit, asfaltimin dhe rekonstruimin e rrugëve në fshatrat Leran, Miratoc dhe Cakanoc, Geraj, Rohovicë, Norçë dhe Sllavujevc, asfaltimi i rrugës lokale Zhunicë-Bushtran, rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Raincë, rekonstruimi i rrugës në fshatin Corroticë, rekonstruimi i rrugës në vendbanimin Stacioni hekurudhor, adaptimi i Shtëpisë së kulturës “Abdulla Krashnica” për nevojat e RTV Preshevës dhe fakultetit, si dhe për vazhdimin e ndërtimit të shkollës së mesme teknike “Presheva”.

Në komunën e Bujanocit janë investuar 100.341.068,00 dinar për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike në “Sektorin 6”, asfaltimi i rrugës nëpër fshatin Bilaç dhe rrugës Lluçan-Dobrosin, mirëmbajtja e shtuar e rrugëve në fshatrat Drezhnicë, Sveta Petka dhe Kushticë, zëvendësimi i zdrukthëtarisë në shkollën fillore “Branko Radiçeviq” dhe ndërtimi i bllokut në shkollën e mesme “Sezai Surroi”, aktivitetet bujqësore dhe punët në ujësjellësin “Zhbevac”.

Në komunën e Medvegjës janë investuar 39.241.650,00 dinar për ndërtimin e rrugës lokale Pertile-Mrkonje, për ndërtimin e korzos dhe dy rrugëve, ndërtimin e pjesës së rrugës Medvegjë- Crni vrh dhe për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugëve të mëhallave në territorin e kësaj komune.

Nga NIP (Plani Nacional Investiv) janë ndarë 6.381.184,00 dinar edhe atë 2.996.728,00 për komunën Preshevës dhe 3.384.456,00 për komunën e Medvegjës.

Trupi koordinues edhe këtë vit ka siguruar më shumë se 50 milion dinar për projekte të shoqërisë civile, ndihmë për kategorinë sociale dhe mediat.

Në bashkëpunim me institucionet republikane kemi mundësuar hapjen e 62 vendeve të reja të punës në doganë, në administratën tatimore, organet e inspektionit dhe institucionet e tjera shtetërore në komunat Preshevë dhe Bujanoc.

Bursat për 206 nxënës të shkollës së mesme nga komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe mjetet për blerjen e pajisjeve mësimore për nxënësit e klasës së parë nga këto komuna, janë siguruar edhe këtë vit.

Për kategorinë sociale më të rrezikuar Trupi koordinues i ka ndarë secilës komunë nga dy million dinar.

Nga shfaqja e vitit të kaluar “Ti dhe unë jemi ne” ka lindur e ashtuquajtura qendër multietnike rinore nga Bujanoci që me të rinjtë nga Kikinda, Bujanoci dhe Presheva ka punuar në shfaqjen teatrale “Ne jemi e gjithë bota”. Shfaqja është shfaqur në Beograd, Bujanoc, Kikindë dhe Lublanë. Qendra rinore “Ti dhe unë jemi ne” ka publikuar edhe dy numra të gazetës për të rinjë “VivaBu”.

Dëshiroj që posaçërisht të theksoj se nga fondi i Ministrisë për administratë shtetërore dhe vetqeverisje lokale në vitin e kaluar janë ndarë 47.800.000,00 dinar për zhvillimin e bashkësive lokale në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Në Preshevë për bashkësitë lokale Cakanovc, Sllavujevc, Strezoc- Maminc dhe Zhunicë janë ndarë 16.900.000,00 dinar. Në bashkësitë lokale Rakovc, Srpska kuqa, Levosojë, Konçul, Nesalcë, shkollat fillore Branko Radiçević dhe Naim Frashëri dhe qendra sportive Mladost në Bujanoc janë investuar 16.900.000,00 dinar. Në Medvegjë, bashkësinë lokale Rajkovc dhe Banjë të Sijarinës nga ky fond janë investuar 14.000.000,00 dinar.

Këto janë disa nga sukseset tona të përbashkëta në vitin 2010.

Dëshiroj të paralajmëroj dy aktivitete të rëndësishme për këtë vit. Pasi që vitin e kaluar me sukses kemi përfunduar konkursin për punësim të zyrtarëve në doganë, këtë vit do të vazhdojmë me shpalljen e konkursit për punësim në administratën tatimore, doganë dhe inspekcione.

Duke njohur avancimin e arsimit si një nga prioritetet tona strategjike, kemi vendosur që të sigurojmë bursa për studentë nga Presheva dhe Bujanoci të cilët dëshirojnë të shkollohen në universitetet e Serbisë.

Në fund, dëshiroj t'ju siguroj se politika e Qeverisë së Republikës së Serbisë e cila është e orientuar për avancimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës gëzon përkrahjen e partnerëve tanë ndërkombëtar, për çka jam i sigurtë se viti 2011 do të jetë edhe më i suksesshëm në realizimin e qëllimeve të caktuara.

Ju dëshiroj suksese në vitin 2011.

Me respekt,
Milan Marković

kryetar